



Ernest Marku

PACIENTI

sprovë

Pacienti - sprovë

Autori: Ernest Marku

Design: Hekuran Koka
Përgatitur ekskluzivisht për
Bibliotekën Virtuale të Lezhës
një bashkëpunim i
Klubit të Letrave “Ndoc Gjetja”
& Bashkisë Lezhë

Lezhë, Prill 2020

Përmbajtja

<i>Te doktori 1</i>	4
<i>BRENDA PACIENTIT 1</i>	5
<i>Te doktori 2</i>	9
<i>BRENDA PACIENTIT 2</i>	11
<i>Te doktori 3</i>	14
<i>BRENDA PACIENTIT 3</i>	16
<i>Te doktori 4</i>	19
<i>BRENDA PACIENTIT 4</i>	21
<i>Te doktori 5</i>	25
<i>BRENDA PACIENTIT 5</i>	27
<i>Te doktori 6</i>	30
<i>BRENDA PACIENTIT 6</i>	32

TE DOKTORI 1

Doktori: *Shka ankoni?*

Pacienti: *M'dhemb barku doktor.*

Doktori: *Sa kohë ka?*

Pacienti: *Tash një mijë vjet.*

Doktori: *Saaa?*

Pacienti: *Tash dy-tri dit, doktor.*

Doktori: *Thaçë se ike.*

Pacienti: *Nuk e pata edhe aq keq, doktor.*

Doktori: *Vene doren ku t'dhemb.*

Pacienti: *Uuuuu,... termet!*

Doktori: *Shka pate?*

Pacienti: *M'theri fort.*

Doktori: *Vishu! Merr kto barna,... t'hanen do t'vijsh prap!*

Pacienti: *Shka do t'jetë doktor thue?*

Doktori: *Dyshoj për gjallesa...*

BRENDA PACIENTIT 1

Natë! Terr! Fortunë dhe shi! Terr dhe ndonjë dritë e dobët që u villej malit të reve. I ftohti dhe errësira ishin gjërat e më të forta që i ishin ngulur në kujtesë. Shiu edhe pushonte me raste, era më të rrallë. Nuk e mbante mend sa orë kishte kaluar mbi tokë, kur arriti për herë të parë, të kapte diferencën në mes të ditës dhe natës.

Mbrëmbja e parë do t'i ngulej në kujtesë, më shumë sesa agu i ditës tjetër. Ai muzg e trembi. E trembi pafundësia e territ dhe vrasja e shpresës. Tani që kishte parë dritën, e kishte të pamundur të jetonte pa të. Iu tretën fuqitë dhe iu dobësua intuïta, vetëm veshët vigjëlonin. Syri, i cili sapo kishte nisur të hapej e të ndriste, papritur u përmyt në ujë të kripur. Nuk e kish provuar më parë shijen e kripës, as këtë ndjenjë nostalgjicë për diçka të humbur. I mbështetur në degën e pemës, jo larg nga pema ku po rrinin të tjerët, përpiqej të gjente paqen e gjumit, po ndjesia që i kishte dhënë drita dhe frika për humjen e përhershme të saj, nuk e linin të qetë.

Kishte zënë pemën e parë të pyllit, pikërisht atë që shihte andej nga kishte parë atë rreze dielli. Atëbotë nuk e kuptonte se po shihte nga perëndimi. Dikur ëndrrat, shpresat e frikërat, e kishin lodhur dhe i ishte dorëzuar hipnozës së gjumit. Rrezja e parë e ditës së re, kishte pak kohë që kishte rënë, kur atë e zgjuan britmat e të tjerëve. I lumtur dhe i habitur në të njëjtën kohë, pa që drita po vinte nga ana e kundërt. Iu bashkua ngazëllimit të përgjithshëm që nuk pushoi deri sa dielli u ngrit në zenit. Ishte hera e parë që po e shihnin atë lëmsh të zjarritë, një ditë më parë, ata kishin parë vetëm rrezet.

Në një moment, kur dielli u mbulua nga reja, turmën e pushtoi një uturimë mbyhtëse dhe sytë e të gjithëve u bënë det me kripë. Kush mund ta përshkruajë atë gëzim që i kaploi, sapo rrethi i kuq nxori

kokën në brinjë të resë! Gëzimi u fashit sërish kur dielli nisi të zbriste kupës së qiellit, u kthye në frikë kur ai u zmadhua e u bë më i kuq në perëndimin e tij të përflakur, për t'u kthyer në trishtim kur terri mbuloi sërish dhenë. Kësaj rradhe zhgjodhi pemën që shihte nga lindja. Ishte i trishtuar sërish, por shpresa nuk ishte e dobët kësaj nate. E priti rrezen e parë të diellit, që i rrëshqiti mbi syrin e zemrës; kësaj rradhe, ishte britma e tij që do t'i zgjonte të tjerët.

Magjia e së panjohurës kishte kaluar. I ulën sytë poshtë dhe panë njëri-tjetrin. Nuk është se u pëlqeu shumë ajo që panë. Të gjithë po shihnin të gjithë dhe askush veten. Leshrat e dendur që u mbulonin kokën dhe leshrat e butë që luspëronin trupin, kishin kursyer vetëm gjinjtë e femrave. E njohu të ëmën nga aroma e trupit të saj, kurse ai gji i fishkët që e kishte ushqyer dikur, do të ishte gjëja më e dashur që kishte parë e do të shihte. Pa edhe plot gjinj të tjerë dhe po habitej për urinë që e kaplonte për to. Kjo uri, rritej si vullkan, sidomos pasi ngopej me mish të freskët kafshësh. Nisi të hidhte shtat dhe ishte i pari që sulmonte në gjueti. Nuk dinte të ngopej me gjakun e katërkëmbëshave, që ua thyente kokën me gurë. Pasi e shqyente viktimëm, ua hidhte pjesën më të mirë, atyre që sapo kishin filluar t'u rriteshin gjinjtë.

Kishte kohë që i dëgjonte klithmat e natës, nuk ishin klithma kafshësh apo zogjsh. Ishin britma të thella, britma që nuk zgjasnin shumë por që t'i ngjethnin mishtë. Pastaj i dëgjoi edhe ditën, i dëgjoi edhe i pa. Pa meshkujt e kërleshur që ulërinin nga kënaqësia, dëgjoi uturimën e mbytur të femrave që shpërthenin në ekstazë, pak çaste më vonë. Nuk është se kuptoi shumë, po kur pa një gjizbuluar që po shihte edhe ajo pas një gëmushe, u sul mbi të si gjeraqinë. Ndërsa ia thithte plot zjarr gjinjtë e mbushur, vuri re se ato nuk po nxirrnin qumësht. Nuk i vuri rëndësi këtij fakti, por nisi të imitonte veprimet e burrave të fisit. Kur ia ngiti këmbët mbi supet e tij të fuqishme, femra lëshoi një rënkim ngjethës; mirëpo, kur e penetroi me këmbën e tretë që i ishte zmadhuar, gati për të prekur në tokë, ajo klithi dhe e spërkati me gjak, si të kishte therur një gazelë. Në fillim u tremb dhe u kthye sërish me dy këmbë, po kur pa se vajza ishte mirë dhe po i buzëqeshte plot dëshirë, gjaku i vërshoi sërish në mes të këmbëve dhe u vërsul përpara si minatori me pistoletë në dorë, në kërkim të mineralit.

Tani po e kuptonte, pse disa gra ishin me bark të fryrë; ose më

mirë të themi, kuptoi diçka por ndërkohë iu shtuan edhe moskuptimet. Asistimi në një lindje, e mrekulloi dhe trembi njëkohësisht. Teksa shihte foshnjat që po ushqeheshin me gji, gjërat nisën t'i bëheshin edhe më të qarta. E kërkonte përsëri atë femrën e tij, e cila i fshihej dhe largohej me vrap pele prej tij, por kur ky e arrinte, ajo shtrihej vetë në lëndinë, me shalët e hapura e me sytë që i shkëlqenin si maceve në shkurt. Ajo shtëllungë leshi, në mes të luginës ku mbinin këmbët, i dukej si një pylli më magjepës në botë, i cili e joshte drejt humbnerës së kënaqësive të patregueshme.

Kur e gjeti poshtë një mashkulli tjetër, i vloi gjaku në kokë; rrëmbeu një hu dhe ia mbështolli atij pas koke. Në fillim ai u nguros por shpejt e mori veten, u ngrit me këmbën e tretë të squllur por me gjak në sy. Ndërsa ata të dy po përlesheshin me thonj, femra mori zabelin me vrap drejt pemës së fisit. Ndërsa dielli po perëndonte, të bërë plymë në gjak, dikur ata të dy, i lanë forcat e ranë si të shituar mbi bar. Nuk u kishte dalë akoma inati, por këtë tashmë, ua tregonin vetëm sytë. Të nesërmen, e pa sërish atë femrën, por ia dha një troku të tillë, saqë kësaj rralle, nuk e kapi dot. Në të ngrysur e pa me atë tjetrin në krah. Nuk foli. Një javë të tërë, nuk u pa pranë fisit. Kur u kthye, kishte në krah një bionde.

Nisi të shkonte me të tjera. Sherrit nuk ia përtonte, po nuk gjeneronte më inat. Nisi të thurte një shtrat me thupra mbi pemëm e tij. Kjo shkaktoi të qeshura e të tallura nga bashkëmoshatarët. Ai nuk ua varte po punonte i qetë. Kur mbaroi jo vetëm shtratin, por edhe një si punë muri nga ana që frynte gjithnjë erë dhe nga ana ku rrinte fisi, u shtri të pushonte mbi thupra. Një ditë, doli të mblidhte bar të thatë, të cilin e shtroi mbi thupra. Mori edhe dy cungje të vyshkura e i ngjiti në pemë.

Kur ngjiti atje, një nga femrat që e kishte për zemër, nuk shkonte më me të tjera. Meshkujve që e kqyrnin me lakmi nga poshtë, u hakërrehej me shkëlqim luani. Natën, bënte roje deri në mesnatë, ndërsa femra flinte. Në degët ku kishte lidhur thuprat, nisi të varte copa mishi të mbetura nga ngrënjet e bollshme. Kur femrës së tij, nisi t'i fryhej barku, një emocion i ri ia ndezi gjakun. Ishte ai që e priti të birin, kur doli nga shpella e hapur mes pyllit të leshtë. Ai do të ishte i pari baba, që do të njihet nga i biri. Pastaj edhe nga bijtë e tjerë dhe

bijat. Pati dymbëdhjetë fëmijë.

Ditën që ra sëmundja e madhe dhe njerzit po vdisnin si mizat, prijësi i fisit, urdhëroi t'i ngjiteshin malit. Ai ishte i vetmi burrë që mbante mbi supe të vegjlit e tij, teksa ngjitej në të përpjetë, me djalin e madh që hapte rrugën me një hu të gjatë dhe nënën e tij që ishte rrethuar si kloçkë nga fëmijët e tjerë. Nga mesdita i thotë dytit që të ndërronte të vëllanë, i cili u kthye sërish të printe në të ngrysur. Bjeshka iu bëri mirë. Ajri i pastër ua pastroi mushkëritë, kurse uji i kronit ua shtoi fuqitë. Vdekjen e kishin patur mjaft pranë, por jeta vendosi të mos i braktiste, as kësaj here.

TE DOKTORI 2

Pacienti: Jam ma keq, doktor.

Doktori: Gjallesat janë shtue.

Pacienti: Shka i bahet tash?

Doktori: Duhet me t'i ndrrue barnat...

Pacienti: Pse, doktor?

Doktori: Kto drej gjallesash janë t'squeta...

Pacienti: A i mbyt i stofit, doktor?

Doktori: Po e bajmë provë... Kujdes mos t'msojnë me ndezë zjarrm.

Pacienti: Po uji?

Doktori: Po po, langje me pi,... sa ma shumë langje.

Pacienti: A thue mbyten n'ujë.

Doktori: Pa dam e kie... Provoje!

Pacienti: Po tjetër?

Doktori: Po jau ngrij habitatin...

Pacienti: Po ndoj bar, doktor?

Doktori: Antibiotikë, s'po t'nap ksaj here... se u rritet imuniteti.

Pacienti: N'doren tande, o doktor.

Doktori: Hajde, gajret! Langje, sa ma shum langje edhe... mos i shprush gacat.

Pacienti: Shka me ba?

Doktori: Mos shif andrra! Mos u mbshtiehl n'shtroje!

Pacienti: Por njerth, o doktor.

Doktori: Hajde mos druej... çili dritoret e të t'rrahi era.

BRENDA PACIENTIT 2

Kishin kaluar shekuj qyshse kishin zbritë në bregdet. Urat e drunja, për te kasollet e ngrohta mbi ujë, ngiheshin natën si shkallë drejt qiellit. Gjumin nisën ta bënë më të qetë, pse bishat e egra nuk arrin dot deri atje. Kishin ndërtuar edhe qilima prej kashte, kurse mishin e kripnin në ujët e deti. Peshqit, i hanin vetëm kur i lodhte uria. Burrat e vertetë, nuk bini aq poshtë sa të ushqenin familjen me peshk. Dita ishte e gjuetisë, kurse nata fillonte me prralla për të vënë fëmijët në gjumë, vazhdonte me seks për t'i shtuar dhe përfundonte me ëndrra që i ndihmonin të krijonin mite e legjenda për natën tjetër, pasi fëmijët nuk flinin me të njëjtën histori përnatë.

Gjuetia, po bëhej përherë e më e rrezikshme. Nuk dihet sesi u shfaqën disa kafshë gjigande, me një luajtur të bishtit ato rrëzonin shtatë burra. Ai filloi të mendonte përballjen me ta. Bashkë me grupin e tij, hapi një gropë të thellë sa njëzet bojë njeriu. E thërrisnin Dritan, pasi sipas legjendës, ai trashëgonte gjakun e burrit të parë që pa dritën në tokë. Atëbotë u shfaqën mamuthët, më të mëdhenj e më të tmerrshëm se dinosaurët. Dritani nuk u tremb po nguli në fund të gropës, trungje me maje të mprehtë. Kur arritën të gënjenin mamuthin a parë që ra mbi hunjtë e mprehur, britmat e tij u ndien deri në Malin e Shenjtë. Atë muaj, gjithë fisi festoi. Mishi i mamuthit ishte i fortë e i ashpër, por mjalti i bletëve ua turbullonte mendjen e ua shtonte epshin.

Pasqyrimi i fytyrës mbi ujët e kthjellët, u mundësoi të njihnin veten. Ndonëse nuk kishte ndonjë ndryshim të madh me fytyrat e tjera të fisit, disa syresh, nguleshin me orë të tëra duke parë këtë pasqyrim, me shpresë së do të gjenin shenjat e superioritetit të tyre e duke ushqyer kështu, karakterin e tyre egoist e ndjenjat lakmitare. Në atë kohë, nisën të flisnin më qartë, si edhe t'u vinin emra sendeve.

Kur zbuluan se lëngu i rrushit mund të fermentohej, festat e orgjitë u bënë më të shfrenuara. Dollitë me verë e me kofshë mamuthi në dorën tjetër, nuk mbaronin deri herët në mëngjes. Shpesh, gjuetarët binin viktimë e mamuthëve, por Dritani ua mësoi huqet dhe grupi i tij nuk dështoi asnjëherë. Dështimi ishte baras me vdekje. Në fakt, vdekja, më së shumti, po u qasej në një mënyrë tjetër. Filluan të vrisnin njëri-tjetrin, të trullosur nga calikët e verës që thanin, të nxitur prej fjalëve të gërgasëve, apo të egësuar prej xhelozisë, ndjenjë kjo që nuk dihet se kush e solli. Dritani kandidoi për kryetar fisi po nuk fitoi, dera e tij nuk kishte fituar kurrë.

Të gjitha këto, nuk ishin asgjë përballë tmerrit që i priste. Dritanit i ishte shfaqur në ëndërr katastrofa ndaj, mori familjen e tij e u nis për nga tokat e stërgjyshëve në Malin e Shenjtë. Ishin akoma në gjysmë të së përpjetës, kur e dëgjuan uturimën; ndërsa, sa dolën mbi një kep poshtë majës, e kuptuan se ç'kishte ngjarë. Në çdo anë, syri të shihte që kasollet, lëndinat por edhe pyjet e pishave, të gjitha i kishte gllabëruar deti. Emrat e fëmijëve të tij, do të bëheshim emrat e fiseve që do të popullonin këtë anë të botës. Në këtë jetë të re, të ftohtit ishte armiku më i madh. Guvat e thella e të errta, pak i ndihmonin në këtë drejtim. Lindën plot fëmijë të tjerë, por shumica nuk e shtynin dot as muajin; gjinjtë e grave nisin të shternin dhe nata u bë dyfish e ftohtë.

Dritani, shpesh nisej për ekspedita kërkimore. Ai ndihej përgjegjës për familjen e tij të madhe, që po kthehej në një fis të ri, por edhe për fisin e vjetër, të cilin, ishin vetëm ata që po e trashëgonin. Kur ndeshi në fosfor, përveç ngjyrës së kuqe, asgjë tjetër s'ë tërhoqi. Ishte i thërmueshëm, kurse uji ia ndryshonte edhe ngjyrën. E fshehu diku në shpellën kryesore, në një vend të thatë e pa dritë. Mërkurin e mblodhi në një lëvore lisi të moçëm. Kur arriti te shpella pa se kishte ngrirë. I mërzhitur, hodhi lëvoren e veshur me zhivë diku pranë fosforit dhe doli sërish të kërkonte diçka të re. Kur po kthehej, në muzg, pa disa gjuhë të kuqe që po dilnin nga gryka e shpellës. Gratë e fëmijët, të përzhitur e të frikësuar kishin marrë shpatin. Dritani iu afrua shpellës. Në fillim, gjuhët e zjarrit shpërthenin papritur, për t'u tërhequr sërish para një sulmi të ri. Kur sulmet u rralluan, Dritani guxoi të afrohej edhe më. Futi njëren dorë në gjuhët e flakës, por shpejt e tërhoqi. Kur flaka u tërhoq në brendësi të shpellës dhe ai që po e ndiqte nga pas,

papritur, vuri re se ambjenti ishte ngrohur. Kur flaka u tkurr atje ku kishte nisur, Dritanit, nisi t'i dhimbsej ajo kafshë me gjuhë të kuqe. Doli me vrap jashtë, pa si i hutuar rreth e rrotull, mbledhi disa degë pemësh dhe i hodhi mbi zjarr. Sërish u tremb kur shpërthyen gjuhët e flakëve, por ngrohtësia e rifituar ia shtoi entuziazmin. Doli të kërkonte ndihmë. Atë natë, ndenjen zgjuar deri vonë rreth zjarrit bubulak, i cili kishte shpërthyer aksidentalisht, teksa njëri nga djemtë po luante me zbulimet e babait.

Tashmë, mishin e hanin të pjekur, edhe ushtat i mprihnin më mirë, edhe lëkurat e kafshëve i kthenin në veshje. U kthyen sërish ditët e lumtura, derisa xhelozia, smira, lakmia e egoizmi, të cilat nuk ishin mbytur në ujë, dolën sërish në sipërfaqje. Vrasja brenda fisit, këtu ishte pothuajse vëllavrasje. Dritani ishte plakur mjaft dhe ndihej i pafuqishëm, për të kontrolluar situatën. Vuajtja e rreziku, i afronte njerëzit me njëri-tjetrin; kurse ditët e qeta e të sigurta, i kthenin ata në armiq.

Ishte sërish diçka e keqe, ajo që do ta mbyste sherrin në fis. Vdekja erdhi sërish me kosë në dorë dhe Dritani nuk mundi të bënte asgjë. Deti kishte filluar të tërhiqej duke liruuar territoret e pushtuara. Kjo ishte e vetmja shpresë. Dritani i mbledhi të gjallët dhe i urdhëroi të zbrisnin luginës së larë nga shirat, të cilat sapo kishin nisur. Kur fisi i ri, u nis në kërkim të fatit të tij, plaku u ngjit me zor të madh mbi një krep të lartë, ku nuk ishte hedhur rrënjë akoma sëmundja e tmerrshme. Nuk mori aspak ushqim me vete. Fundin do ta priste, duke shijuar vetëm ajrin e pastër dhe dritën e diellit. Atje ku ishte, mbi krep, mbledhi fuqitë e fundit dhe lëshoi një uturimë, mbi fisin e tij që shpejtoi vrapin mbi luginë.

TE DOKTORI 3

Pacienti: Do dit kiejë ma mirë...

Doktori: Po masandej?

Pacienti: Masandej m'kapi prap dhimbta e barkut.

Doktori: Duket, duket...

Pacienti: Shka duket, doktor?

Doktori: Kto gjallesa t'poshtra... U pakuen, por s'u zhduken.

Pacienti: E un piva tanë at ujë... edhe zjarmin nuk e yshta.

Doktori: S'e bane ti po dikush, dikah... ua shprushi gacat.

Pacienti: Ah Promete, Promete!

Doktori: Veç n'paçin ndertue anie n'mal...

Pacienti: Ah Noe, Noe!

Doktori: Nuk qiten faret kollaj, jo...

Pacienti: Po tash, doktor?

Doktori: Po jau nis deken me gjylpanë.

Pacienti: Boll ushtri ke nisë me barna...

Doktori: Jo, jo ma me ushtarë...

Pacienti: Po me shka?

Doktori: *Jau shpifa dishka atyne... njashtu s'i t'u shpifen ata ty.*

Pacienti: *A ka fund kjo lojë, doktor?*

Doktori: *Na luejmë lojen tonë e ata tynen... veç AgjiaKuaranta i psh-ton.*

Pacienti: *N'doren tande, doktor!*

Doktori: *Me durim, regjim e me ndihmen e Zotit!*

BRENDA PACIENTIT 3

Dritan Uku i Uk Dritanit ishte ndërtues mjaft i njohur. Nga Bregu i Detit e deri te Mali i Shenjtë, kush kërkonte të ndërtonte një shtëpi prej guri, të madhe e të sigurt, merrte Dritanin dhe të bijtë. Qysh se ishte zbuluar hekuri dhe kishin dalë në skenë farkëtarët, veglat e punës ishin përsosur dhe mjeshtrit, kishin mundësi të tregonin më mirë aftësitë e tyre. Daltën dhe çekiçin, Dritani i trashëgonte nga gjyshi, të cilit, ia kishtë punuar një dajë i tij që ishte kovaç, diku në rrafshinën pertej Malit të Shenjtë.

Qyshse kishin dalë monedhat e florinjta, të argjenta, apo edhe ato prej bakri, njerëzia kishte krijuar mundësinë të akumulonte pasuri të mëdha e për pasojë, të investonte në vepra gjithnjë e më ambicioze. Tashmë kishin nisur të ndërtoheshin qytete të tëra prej guri. Dikush i quente kështjella e dikush kala. Nëse shekuj më parë, njerëzimi mendonte që të mbrohej nga kafshët e egra apo nga fatkeqësitë natyrore, tashmë ato mendonin më tepër që të mbroheshin nga njerëzit e tjerë. Verdhushkat ngjallnin lakminë e atyre që nuk i kishin, ndaj një pjesë e rëndësishme e tyre, harxhohej për mure e bedena.

Kishte vite që Dritani me të bijtë, ishte punësuar pranë një bujari vendas, që po ndërtonte një kala të pashoqe. Bujari, i cili vinte nga një derë e shquar e Malësisë, kishte zbritur këtu në Breg të Detit, pikërisht aty ku mali hynte si pykë mes dy fushave dhe kishte vendosur që ta rrethonte të gjithë kodrën me gur të gdhendur. Dritani, kishte filluar të kuptonte, se mund të mos i mjaftonte një jetë, për ta përfunduar atë kala. Kishte tentuar ta prishte kontratën me Bujarin, por ai i kishte rritur pagën dhe i kishte lënë dorë të lirë në drejtimin e punëve. Të gjitha këto përfitime, nuanca lirie dhe stërpikla pushteti që po gëzonte, nuk ishin gjë tjetër, veçse një tregues i qashtër i faktit që ai, ishte një i burgosur në atë kala. Ato mure të latuara, do të ishin lavdia

dhe varri i tij. Hapi një gurore të re, punësoi malësorë të fuqishëm, nga ata që ishin gati ta hanin malin me dhëmbë, por sërish, rrudhat në ballë i shtoheshin më shpejt, se sa rriteshin muret e kalasë. Ndërsa po mbikqyrte transportin e gurëve, që i hante më shumë kohë sesa nxjerrja e tyre, mendja e tij gjenaliale, filloi të mendonte për një mekanizëm të ri. Rrotat e para, u thyen pa ecur dot as një pash dielli kohë, po kur i bëri prej një guri të bardhë, fama e tij, kapërceu edhe përtej detit.

Muri i kalasë, nga veriu ishte ngritur shtatë bojë njeriu, nga jugu katër-pesë bojë, kurse nga perëndimi sa kishte filluar të hidhte shtat, kur ja behu Bajlozi i Zi me ushtarët e tij. Gjer atëbotë, në ato anë, nuk kishte parë kush ushtarë me helmata e parzmore çeliku. Edhe shpatat e tyre ishin më të forta e më të mprehta. Malsorët qëndruan me heroizëm, muret e kalasë u vaditën me gjak djaloshtar, por ushtarët e zinj ishin të panumërt dhe humbja ishte e pashmangshme. Ditën që kalaja ra, të mbeurit gjallë i pllakosi zija. Disa i kaluan në shpatë, të tjerët përfunduan si skllëvër... hera e parë që flitej për skllavëri në ato troje. Vetëm Dritani me të bijtë shpëtuan. Ata u morën sërish në punë për të përfunduar kalanë, këtë rradhë për lologari të Balozit të Detit. Ditën kur po vendosnin gurin e parë pas lufte, nga mali për karshi, u dëgjuan tingujt e një lahute. Ushtarët morën malin si vetëtima. Një bard i verbër po i këndonte lavdisë së malsorëve që ranë për atdhe. Balozit i Zi, kur ia përkthyen vargjet e lahutarit, nuk e vrau por, vuri buzën në gaz, u fry si kokosh e tha: Paskam vrarë trima e çfarë trimash.

Netëve të gjata, ndërsa ngrohej pranë zjarrit bubulak, mes daltave e rrasave të gurta, Dritani nisi të mendonte për shkrimin e fjalëve. Ato vargjet e bardit plak e të verbër, pas vdekjes së tij mund të harroheshin dhe ky mendim, i therte mu në shpirt. Nisi të gdhendëte mbi rrasa disa simbole e shenja si kërraba. Nga mesnata mendonte se kishte bërë diçka, por në mengjes i thyente të gjitha këto pllaka. Kishin kaluar gati dhjetë vjet, kur Dritani nisi të besonte se kishte shpikur një alfabet. Bardi plak kishte vdekur, po vargjet e tij i kishte mësuar një skllav i ri. I shkroi të gjitha këto vargje, mbi disa pllaka që i mbështeti mbi muret perëndimore të kalasë, mure të cilat kishin përfunduar tashmë. Ishin duke festuar përfundimin e kalasë, kur në qytet shpërtheu mortaja.

Vdekja e zezë, nuk kursente as pleq as të rinj, as gra

as fëmijë. Bajlozi u mbyll në kullën e tij, me shpresë se do të shpëtonte prej saj. Ushtria i mblodhi të infektuarit dhe i mbylli në një bodrum në anën jugore të kalasë. Javën e dytë, nisën të sëmureshin dhe ushtarët. Në të sosur të javës së tretë, vdiq edhe djali i vetëm i Bajlozit të Zi. Kur më në fund, mortaja u largua, vdekja kishte korrur nëntë nga dhjetë banorë të atij qyteti. Bajlozi nisi të pinte e të rrihte njerëzit në pijetore. Gruaja e tij u çmend, kurse ai përdhunonte shërbëtoret dhe bareshat rrotull kalasë, derisa e vrau një nga ushtarët e tij. Thuhej se edhe ai, ishte i biri i tij dhe i një bareshe.

Edhe Dritanit i vdiqën pesë djem. Ai që i ngeli gjallë, kishte një djalë, por gruan ia kishte marrë vdekja e zezë. Kalaja kishte përfunduar, muret e saj ishin bërë gati të pakapërcyeshme, por armiku kishte ardhur një rrugë tjetër. Me këto mikrobe si mund të luftoje?! Barërat dhe puplat e ziera të shpezëve të malit, që i përdorte një heqim që kishte ardhur nga përtej detit, ose nuk bënë fare efekt, ose filluan të bënin derman, vetëm kur mordja nisi të tërhiqej. Kishte vdekur edhe skllavi që kujtonte vargjet e bardit plak. Dritani, mblodhi fëmijët e mbetur gjallë dhe nisi t'u mësonte alfabetin e tij. Ditën tjetër, gjysma nuk i erdhën në mësim. Në fund të javës, kishte mbetur vetëm njëri, i cili, i kërkoi që t'ia lexonte fjalët që shkruheshin në ato pllaka. Kjo gjë u përsërit tri herë, derisa, më në fund, djaloshi i mësoi fjalët përmendësh. Dikush solli një lahutë dhe tingujtë e saj së bashku me bëmat e heronjëve, jehuan sërish rrëzë mureve të kalasë. Kënga shpëtoi, po për pllakat e Dritanit, nuk donte t'ia dinte njeri. Ajo anë e kalasë ishte e pabanuar, andaj, dheu e grami që rritej mbi të, dalngadalë nisën t'i pushtonin. Ditën që Dritani vdiq, u varrosën edhe ato rrasa.

Uk Dritani i Dritan Ukut, u martua për herë të dytë, kësaj rradhe me një bareshë nga mali i përtejme. Me këtë grua, pati dymbëdhjetë fëmijë. Kur djali i madh i tij, mësoi të përdorte harkun, kalaja u mor së rish nga malësorët e malit përtej, dajat e këtij djali. Ardhja e malësorëve, e gjallëroi sërish jetën e kalasë. U shtuan lahutat e bardët, jehuan këngë të reja e të vjetra. U bënë shumë dasma e lindën plot fëmijë. Jeta kishte triumfuar sërish.

TE DOKTORI 4

Pacienti: Prap e njahta punë, doktor... sa kam dalë dje prej ktuhit, m'nisen dhimbtat

Doktori: Ehë...

Pacienti: Shka po duket puna n'at alet?

Doktori: Kqyre si ka ndrrue boja... e kanë shndrrue habitatin.

Pacienti: Janë shumue dreqnit.

Doktori: Duhet me ndrrue strategji.

Pacienti: E shka duhet me ba, doktor?

Doktori: Duhet me bashkpunue me ta.

Pacienti: E qysh bahet kjo punë?

Doktori: Ata duhet me të dashtë ty.

Pacienti: E si dreqin?

Doktori: Po të vrane ty, do t'shuhen edhe ata...

Pacienti: Kjo dihet, po qysh me folë me ta?

Doktori: E kam nisë lajmsin.

Pacienti: Kjoftë I hajrit!... E tash?

Doktori: Tash po presim nja dy javë.

Pacienti: *Po kumti kush a?*

Doktori: *Ata i krijove ti vetë,... simbas shembelltyres tande!*

Pacienti: *E pse dreqin?*

Doktori: *Prej dashnisë.*

Pacienti: *M'bane per psikolog, doktor.*

Doktori: *Kjo asht shpresa e fundit.*

BRENDA PACIENTIT 4

Dritan Pellazgu, atë ditë, kishte dalë më herët se zakonisht. Një ëndërr e çuditshme ia kishtë prishur qetësinë e gjumit, duke ia turbulluar kthjelltësinë e mendimit. Pa arritur te porti, në sheshin e pazarit, vuri re një turmë të vëmendshme të mbledhur në formë rrethi. Në mes të tyre, një burrë i gjatë me një shkop gjithë nyje dhe me një trastë të rreckosur te këmbët. Fliste për një të ngjitur në kryq, për mëkatin e parë dhe për rrugën drejt së vërtetës. Dritani u hodhi një sy njerëzve që po dëgjonin. Aty kishte barinj, shërbëtorë, skllevër, artizanë të pavarur, por edhe tregtarë të kamur, zyrtarë të perandorisë, ushtarakë karriere, deri dhe ndonjë politikan të regjur. Dikush dëgjonte i mrekulluar, një tjetër gjithë dyshim, apo me një nënqeshje të hidhur. Kur predikusi tha se kish parë Birin e Zotit, të të vetmit e të vërtetit, turma nisi ta fishkëllente. Ndërsa, kur i ftoi në pendim që të shpëtonin shpirtin, e gjuajtën me gurë.

Dritani, nuk lëvizi as gishtin. As gjuajti me gurë, as foli, as bëri ndonjë reagim tjetër. E ndoqi me sy predikuesin endacak, teksa largohej me trastën mbi kokë dhe duke u përplasur me qoshet e mureve. Nuk ndjeu vetëm dhemshuri, por edhe një lloj pasigurie. Po sikur ai të kishte të drejtë?! Jo!... Ata i kishin zotat e tyre. Katragjyshi i tij, Dritan quhej edhe ai, ishte kthyer në perëndi, që kur kishte sjellë zjarrin në tokë. Me atë zjarr, ai krijonte shigjetat e tij, me të cilat gjuante armiqtë e kundërshtarët. Askush nuk matej me të, as në tokë as në mes të perëndive. Dikush e quante Bubulluesi e dikush tjetër, Dybrinjëshi. Flitej për një dhi e për qumështin e saj të shenjtë, por më shumë flitej për një gur. Beja në gur, ishte beja më e fortë në këto troje.

Dybrinjëshi, vinte 36 breza pas atij që pa dritën i pari. Ai kishte qenë Dritani i parë. Para tij, bota kishte qenë e zhytur në errësi. Si mund të besonte në një Zot të ri, në një Zot që po sillte në këto

anë një leckaman, kur ndërkohë, ai vinte drejtpërdrejt nga ajo linjë e pastër e perëndive të Malit të Shenjtë. Bubulluesi ishte kryeperëndia, Këmbëshpejti ishte perëndia e lumenjëve malorë e përrenjëve të rrëmbueshëm, Bindi ishte perëndia e forcave të mbinatyrshme, Premti ishte perëndia e fjalës së dhënë, Thënia ishte perëndi e mendjes dhe dijes, Nëna Tokë ishte perëndi e pjellorisë, Afërdita e agut të mëngjesit, kurse Herdhemadhi ishte lajmëtar i jetës.

Dritani ngau drejt punishtes së tij, i kishin ardhur disa ide të reja për skulptura. Do t'i bënte perënditë, jo vetëm të fuqishme e të frikshme, por edhe njerëzore, të buta si shpirtra që dashurojnë. Nuk ishte i sigurt nëse këto ide, kishin lidhje me ëndrrën që kishte parë, apo me predikimin e atij mëngjezi. Ndihmësit, nuk kishin ardhur akoma, andaj, pregaditi një çaj me bimët e malit mbi kala dhe u ul që ta gjerbte me sytë mbi terrakotat e porositura nga krykomandanti i ushtrisë së perandorit në ato vise. Nuk i pëlqenin ato vizatime mbi qypat e baltës, por, rëndësi kishte që t'i pëlqenin Bajlozit të përtej detit. Kurse skulpturat, ato do t'i bënte sipas qejfit të tij, do t'i bënte nën këtë dritë të re. Nuk i pëlqenin as skulpturat që ishin vendosur te porti, as ato që kishte bërë për tregtarët e pasur. Do të punonte ndryshe, ndryshe... Po, si?... I futi duart në baltën e njomë e nisi të krijonte disa trajta. Erdhën ndihmësit, por ai as që ua hodhi sytë. Befas e prishi krejt punën që kishte bërë deri atë çast, doli në verandë dhe nisi të pinte një gotë verë, duke kundruar retë e qiellit, të cilat nisën t'i duken si elefantë të bardhë.

Kur i përfundoi statujat, i gjithë qyteti u turr drejt punishtes së tij. Të parët u mrekulluan. Më vonë u shfaqën dyshuesit. Si mund të ishin perënditë të ngjashme me njerëzit?! Dikujt nuk i pëlqeu dliresia e lakuriqësia e trupit, të tjerët kërkonin diçka që t'u ngjallte frikë. Pamvarësisht këtyre mendimeve, qytetarët kishin respekt për Dritanin, ndaj askush nuk e gjuajti me gurë. Me gurë nuk e gjuajtën, po një statujë ia thyen. Ia kishte falur qytetit për ta vendosur aty ku kishte folur atë ditë ai endacaku. Ndërkohë, u shfaq një endacak tjetër, më trupvogël e më i brishtë se i pari. Pas tij lëviznin gjithnjë, njëzet a tridhjet vetë, që dukej sikur e adhuronin. Dritani u dha bukë e ujë, kurse predikuesi e bekoj me dy lëvizje të ngathëta të shkopit të tij. I erdhi për të qeshur, por ai shkëlqim që vuri re në sytë e tij, e futi në

mendime. Kishte një mister në këtë histori dhe misteret ishin joshëse, më joshëse se të vërtetat. Misteri i shenjtë, kishte fuqinë që të qetësonte shpirtërat e plagosura nga e pamundura dhe mendjet e friksuara nga e panjohura. Uhodhi një sy skulpturave të tij të reja. Tani nuk i pëlqenin as ato.

Kur po festonte pesëdhjetë vite mbi këtë tokë, deti u egërsua dhe pushtoi qytetin. Shumë u mbytën, të tjerë humbën mallin, por kjo nuk e mposhti qytetin. Ajo që u futi tmerrin të gjithëve, ishte kolera që shpërtheu më pas. I gjithë qyteti u mbyll brenda kalasë për dyzet ditë. Kur e keqja u largua, popullsia e qytetit ishte përgjysmuar. Statujat e Dritanit kishin humbur, ishin vjedhur, ose dergjeshin përtokë të thyera e të baltosura. Gjatë këtyre dy muajve, predikuesi me endacakët e tij, nuk kishin qenë në qytet. Kur zbritën nga pylli me lisa, qyteti po pastronte rrugët.

Perandoria, nuk ishte më aq e frikshme dhe e pathyeshme si më parë. Nga veriu po zbrisnin fise të egra, njerëz të pamëshirshëm, të shpejtë si ketri, e të fuqishëm si luani i uritur. Kryekomandandi, urdhëroi forcimin e mureve. Gurë nuk kishte shumë; rrugët malore, ishin të zaptuara tashmë. Në bedenat e fundit, në anën lindore, një nga ustallarët rراسi në mur edhe ato librat e trashë të veshur me lëkurë ariu. Dritanit iu kujtuan pllakat me shkronja të stërgjyshit të tij. Askush nuk mendonte për gjë tjetër, kjo nuk ishte një luftë si të tjerat. Ishte luftë për jetë a vdekje. Trimat ngjeshën shpatat e mprehën shigjetat, kurse lahutarët akorduan telat. Vetëm ata që flisnin për të ngjiturin në kryq, uleshin në mes të sheshit dhe i luteshin Zotit të tyre.

Kur, më në fund, barbarët e pushtuan kalanë, kursyen vetëm ata që luteshin. Natyrisht që shpëtuan edhe të tjerë. Pylli i lisava u mbush me kaçakë. Disa madje, u ngjiten edhe në pyllin e pishave të zeza, deri pranë kullotave në bjeshkë. Nuk flitej më për libra e statuja, vetëm bardët këndonin këngët e tyre të reja e të vjetra. Dikush solli një këngë, e cila fliste për një kala që ishte shkatërruar nga dashuria. Kishte qenë një femër, një perri e vërtetë, ajo që ia kishte marrë mendjen, djalit të mbreti të asaj kalaje. Djaloshi e grabiti shtojzovallen edhe pse ajo ishte gruaja e një mbreti tjetër. Mbretër e perëndi ishin ngritur në këmbë për ta shkatërruar atë kala. Sa trima ishin vrarë në ato beteja?! Sidomos njëri, ai që e kishte mbajtur e ëma nga thembra, ai ishte më

trimi, më i shpejti e më i zoti nga të gjithë. Edhe ai u vra. Një tjetër nuk shihte udhën për në shtëpi. Udhëns'sheh apo Odhise quhej.

U shtuan predikuesit. Ata filluan të flisnin edhe në qytet, ku sundonin barbarët; por edhe në pyll, ku flinin kaçakët. Një botë e re po lindte mbi gërmadha.

TE DOKTORI 5

Pacienti: S'und durova dy javë.

Doktori: Nuk duket keq puna.

Pacienti: Mos ban hajgare me mue, doktor.

Doktori: E kam pernjimend.

Pacienti: Mue m'mbyten dhimbtat, ti thue asht mirë puna.

Doktori: Duro, he burrë i dheut... Randsi ka qi ata e kuptuen me-sazhin.

Pacienti: E shka po bajnë?

Doktori: Ata po flasin per planifikim familjar... per botë t'gjelber.

Pacienti: Ndryshe flasin e ndryshe bajnë.

Doktori: Ata t'adhurojnë!

Pacienti: E shka ta baj un ket gja... Ata janë tue m'vra.

Doktori: Saber, saber... Nisa edhe 'i lajms tjeteter.

Pacienti: Shka dreqim pret prej tyne?

Doktori: T'jau turbulloj pak kryet.

Pacienti: A nuk duhej me jau kthjellue?

Doktori: Rrugtë e shkencës janë t'pafundme.

Pacienti: *A thue?!... A po ma ban nji gjylpanë?*

Doktori: *Ani... qe ta bana, veç mos prit shumë prej sajna.*

Pacienti: *Si thue me pi langje prap?*

Doktori: *Pi, pi... ama, dije se ja kanë marrë doren asaj pune.*

Pacienti: *A ta tund njisherë?... Ata qes zjarrin qi kam permbrenda?*

Doktori: *Te tana bani... por, veç fiton pak kohë e qeti, kurrnja tjetër.*

BRENDA PACIENTIT 5

Dritan Uku i Uk Mehmetit, kishte dy muaj që ishte zhytur në arkivin e bibliotekës, në manastirin e benediktinëve, rrëzë Malit të Shenjtë. E kishin dërguar barinjtë dhe fshatrat e rrjedhës së mesme të Drinit, me misionin për të gjetur statuset e vjetra të qytetit të zhdukur, në toponimin e sotëm të quajtur Kastrë. Diku aty nga dita e tretë e kërkimit, mendoi se gjeti diçka, por shpejt u zhgënjye. Sa shumë qytetshetete e sa staturë paska patur kjo anë e Adriatikut. Qyshse Perandoria e Lindjes kishte ndërruar padron, kishin ardhur kohë të vështira për këto qytete-kështjella. Ata, për shekuj e shekuj me rradhë, kishin refuzuar të ishin pjesë e perandorisë, kishin hartuar statuset e tyre, me anë të të cilave rregullonin mardhëniet e tyre, si edhe mardhëniet me tregtarët e botën jashtë mureve të qytetit. Perandoria e Lindjes, kishte rënë në duart e disa sundimtarëve ambiciozë dhe luftarakë, që nuk ishin shumë të interesuar për negociata e të drejta staturore. Mirëpo, kohët e fundit, ata kishin ndërruar taktikë.

Fshatrat e rrjedhës së mesme të Drinit, së bashku me barinjtë e Malit të Shenjtë, kishin ngritur krye ndaj Subashit të Kështjellës mesjetare të Ura e Drinit. I kishin shkruar letër Mëkëmbësit të Perandorit në qytetin e rrethuar në tre anë nga uji, ku i kërkonin respektimin e kanoneve të vjetra të Kastrës. Mëkëmbësi, i cili ua njihte trimërinë, huqet dhe këmbënguljen këtyre malësorëve, vendosi të lëshonte pe. Por doli një problem. Ai kërkonte statuset e humbura të qytetit të Kastrës. Malësorët i kërkuan ndihmë Uk Mehmetit të Mehmet Gjergjit. Ai kishte një djalë që studioje në kryeqytetin e Perandorisë së Perëndimit. Dritani po mbronte doktoraturën për jurispruencë dhe u gjet i gatshëm për këtë ekspeditë kërkimore, që nuk po dilte aq e lehtë sa e kishte menduar fillimisht. Gjuha kishte evoluar gjatë shekujve, po ashtu emrat e vendeve e qyteteve, ndryshonin sipas shijeve të sundimtarëve që shkonin e vinin.

Mehmet Gjergji, gjyshi i Dritanit, kishte qenë i pari fshatit rrëzë kalasë së vjetër, që kishte pranuar Zotin e Perandorit të ri të Lindjes. Pak më vonë, këtë veprim, e kishin bërë edhe të tjerë, deri sa fshati u nda në dy pjesë: gjysma përqafoi besimin e ri, kurse gjysma tjetër i qëndroi besnike besimit të vjetër. Që atëherë, fshati nuk bëri më hajër, mer njerëzve hyri grindja, vrasjet dhe djegiet e kullave. Pas vdekjes së Mehmetit, Uku iku nga fshati dhe u vendos në qytetin midis ujrave. Fshati nisi të rrudhej për ditë e më tepër, derisa sot, kur Dritan Uku po kërkonte për kanone të vjetra, atje banonin vetëm disa barinj dhe një plakë kërcune.

Ky Zot i ri, që kishte sjellë Perandori i Lindjes, nuk është se ndryshonte shumë nga ai i mëparshmi. I dërguari i tij, kishte qenë një udhëheqës i njerëzve në shkretëtirë. Ai kishte luftuar vetëm në mbrojtje dhe kur, më në fund, ai vendosi të sulmonte, të gjithë i kishin ulur armët dhe i kishin rënë në gjunjë. Mirëpo, nuk po ndodhte kështu me pasardhësit e tij. Ata po e çanin rrugën e historisë me shpatë në dorë. Edhe perëndimi e besimi i vjetër, i ishin përgjigjur me të njëjtën monedhë, derisa, dy perandoritë u ndanë dhe e caktuan kufirin, pikërisht në këto troje të vjetra pellazge. Qysh nga ajo kohë, këtu nuk jetonte gjatë, asnjë punë e mirë e as një ide progresive. Këto lugina, u zhytën në terr dhe po konsumonin gjithë inatin e botës, meritë e reja e të vjetra; derisa e tretën të gjithë “dhjamin” e akumuluar në shekuj, për të dalë në prag të periudhës moderne, me disa barinj e do bardë me lahutë, që dukej sikur vinin nga antikiteti.

Dritani, nuk e kishte humbur akoma shpresën për të gjetur statutet e vjetra të Kastrës, kur toka nisi të lëkundej fuqishëm. Një tërmet i tillë, nuk mbahej mend në këto anë. Brenda disa minutave, i gjithë manastiri u kthye në gërmadhë. Pas disa ditë kërkimesh, Dritanin e llogaritën për të vdekur. Atë ditë në bibliotekë, kishte qenë vetëm. Në bregun tjetër të Adriatikut, kishte shpërthyer një vullkan, një krater në dukje i shuar. Për të dytën herë në histori, një qytet po zhdukej nga faqja e dheut. Lajmet që vinin nga përtej Atlantikut, flisnin për cuname dhe erëra detare të fuqishme, të cilat godisnin brigjet e kontinentit të ri. Dukej sikur po vinte fundi i botës, por pas disa muajsh, çdo gjë u fashit.

Një ditë prej ditësh, kur askush nuk e priste, u kthye Dritani.

Kishte shpëtuar për mrekulli, atje në bodrumet e manastirit. Gurët e ciklopikë që ishin përdorur për ndërtimin e atij kuvendi, kishin rënë mbi njëri tjetrin, duke e ruajtur mes tyre studiuesin e tmerruar por të padëmtuar. Dritani, i kishte dëgjuar kazmat e lopatat që gërmonin mbi kokën e tij, kishte tentuar të thërriste me grykët e tij të thara nga pluhuri i manastirit të shembur, po zëri i kishte dalë i ulët e i hollë, sa edhe vetë mezi e dëgjonte. I kishte rënë të fikët dhe ishte krejt i alivanosur, kur e gjetën disa malsorë që kishin dashur të merrnin gurët ciklopikë, për t'i vënë në themelet e kullave të tyre. Para se të kalonte në koma klinike, siç e gjetën malësorët, Dritani u ishte lutur të gjithë zotave me rrallë, të vjetrit edhe të riut, deri edhe atij të vjetrit vjetrit fare, apo më mirë të themi perëndive pellazgjike. Të gjithë zotave u kishte bërë premtime të mëdha në këmbim të shpëtimit të jetës së tij, kurse tani, nuk po i kujtohej asnjë prej këtyre premtimeve.

Meqë e kishte akoma në mendje, misionin e papërfunduar, u nis drejt qytetit që zbriste nga mali drejt e në det. Iu kujtuan shkrimet e stërgjyshit të tij, për librat e murosur në muret e kalasë së këtij qyteti. Një miku i tij, i nxori lejen e gërmimit dhe me disa punëtorë që rekrutoi në sheshin e pazarit, u nis drejt anës lindore të kalasë së braktisur. Pas dy javë kërkimesh, ndeshi në lëkurat e ariut. Ato ruheshin akoma mirë, po shkrimet kishin humbur përgjithmonë, nën erozionin e kohërave me shi. Shtresa e brendshme e lëkurës, ishte komplet e rrafshët e pa shenja në të, kurse brenda saj, Dritani gjeti vetëm pluhur të përhimtë e të ngjeshur si deltinë. Tani që dështoi edhe ky plan, nuk po i rrihej më në këtë anë të Adriatikut. Iku, vetëm një ditë një ditë para se qyteti të mbyllej në karantinë. Kishte rënë sërish vdekja e zezë.

U nis për në kryeqytetin e vjetër të Perëndimit, kishte shpresë të merrte një temë të re për doktoraturën, pasi ajo e para, doli një dështim. Qyteti i Përjetshëm, sikur i bëri mirë; në ajrin e tij iu kthye dëshira për punë dhe për pasojë, edhe dëshira për të jetuar. Aty kishte ardhur edhe një mikja e tij e vjetër, të cilën e kishte njohur në kryeqytetin e ri të Perandorisë së Perëndimit. Së bashku me miken, aplikuan dhe morën temën e doktoraturës për planifikimin familjar. Kjo ishte diçka re dhe krejt e pazakontë, si për universitetin e kryeqytetit të ri, ashtu edhe për sivëllaun e tij në Qytetin e Përjetshëm, por edhe Dritani, e ndjente se po jetonte në një kohë jo të zakonshme.

TE DOKTORI 6

Pacienti: E tash doktor,... u bane dy javë.

Doktori: Ani pse? Ti u msove me ta tash e ata me tye...

Pacienti: Po, por ata janë deka jeme.

Doktori: Ata besojnë n'tye... edhe kur thojnë t'kundërten.

Pacienti: Po veçse m'ngatrrojnë me ndokand tjetër.

Doktori: Pak randsi ka... Ata e kanë hanger gjysen e molles, tashma.

Pacienti: E ku asht e mira ktu?... A nuk deshtem me i largue prej saj-na?!

Doktori: Kur s'hecë një rrugë, asht tjetra. Tash ata e dijnë se duhet m'ë ruejtë habitatin.

Pacienti: Po por nuk e adhurojnë.

Doktori: Kur t' a hajnë krejt mollen, tash vjen edhe kjo.

Pacienti: A thue?!... Po drue dishka tjetër.

Doktori: E shka?

Pacienti: Ata tash, kanë hanger njaq mollë dhe e kanë shpikë edhe at t'keqen e mnerrshme...

Doktori: Po por, nuk guxojnë m'ë perdorue.

Pacienti: *Kush tha?!*

Doktori: *Nuk janë t'marrë!*

Pacienti: *Kanë edhe t'pamend plot... edhe i nderojnë ma shumë se t'tjertë.*

Doktori: *Mos e humb besimin!*

Pacienti: *Te ti, a te Zoti?*

Doktori: *Te loja... Te perjetsija.*

Pacienti: *Amen!*

Doktori: *Amen!*

BRENDA PACIENTIT 6

Dritan Uka, kur po plotësonte ëndrrën amerikane që shkruhej si llotari, nuk e kishte besuar se majin e vitit të ardhshëm, do të ishte duke udhëtuar me concord drejt Shteve të Bashkuara të Amerikës. I ati, Uk Marash Uku, e kishte kthyer mbiemrin në Uka, ndoshta për ta bërë të dukej më modern; apo ndoshta, për të fshehur lidhjet me familjen e shquar Uku, e cila në periudhën e totalitarizmit, ishte shpallur si armike. Dritani ishte rritur në periudhën e rënies së diktaturës, kur përveç ekonomisë, kishte rënë edhe besimi e optimizmi. Revanshi i diktatorit kundër të gjitha besimeve, kishte pasur vetëm një qëllim: apoteozën e kultit të tij. Piramida në mes të bulevardit kryesor të Tiranës, e ngritur për t'u adhuruar si maozelum i diktatorit, përfundoi në një gërmadhë-dëshmi e fundit të toaltarizmit. Shqiptarët, që për kapriço të fatit, e kishin ngritur shtetin e tyre, duke u mbështetur në tolerancën e besimeve fetare; nuk e patën fort problem që t'i braktisnin të gjitha këto besime, për të luajtur teatrin tragji-komik të apoteozës së diktatorit. Po me të njëjtë lehtësi, i shembën edhe statujat e tij, ashtu siç kishin shembur dikur idhujt e rremë.

Dritani, kishte përfunduar studimet e larta për fizikë bërthamore, por punonte si mësues fshati, diku në brigjet e Drinit, gati pesë kilometra larg fshatit të lindjes. Besimin e tij, tek aftësitë vetregulluese të lirisë e të sistemit demokratik, e kishte tronditur rëndë, aftësia e shërbëtorëve të diktaturës për të ndërruar lëkurë, kombinuar kjo me mungesën e besimit të liria: *“E çliruan skllavin, por ai ngeli sërish i lidhur me vargonjtë servilizmit, frikës, injorancës...”*. Pallatet ia ndryshuan pamjen tokës, u shtuan edhe kafenetë e llotaritë, për të përfunduar te biletat e avionëve e trageteve për të ikur nga ky vend një sahat e më parë.

Iu deshën dy vjet që të mësonte gjuhën dhe tri vjet për të

homologuar diplomën, por më në fund përpjekjet e tij u shpërblyen. Filloi punë në një nga centralet bërthamore të Teksasit. Mendonte se kishte arritur në zenith dhe e kishte gjetur vendin e tij, por e ardhmja do t'i ofronte mjaft surpriza. Atje u njoh me një aktiviste të shoqërisë civile, e cila kishte fituar një projekt për mbrojtjen e tokës. Shpërthimi i katastrofës bërthamore në Cernobil, problemet me çarjen e shtresës së Ozonit, mbetjet kimike dhe ndotjet e ajrit, së bashku me dashurinë që i ofroi bukuroshja me origjinë meksikane, e bënë të ndryshonte qëndrim. Shumë shpejt do të hynte në konflikt me drejtuesit, që do ta çonin në humbjen e vendit të punës. Dritani, në fillim u tremb për të ardhmen e tij, por një projekt joshës që arritën të siguronin pranë UNESCOs, ia ktheu sërish optimizmin. Pas katër viteve bashkëjetësë, vendosën të bëjnë një fëmijë. Kur djali mbushi dy vjeç, ata të dy, vendosën që të martohen. Në dasëm i erdhën vetëm dy nga të pesë vëllezërit, kurse i ati i sëmurë, i dërgoi një telegram.

Në fillim, projekti u eci mirë, po kur u konfliktuan me disa shumëkombëshe të fuqishme, Unesco, nuk ua rinoivoi kontratat. Po të mos ishin “Të Gjelbrit” e Gjermanisë që u ofruan dy vende pune si këshilltarë për mjedisin, ata të dy do ta kishin punën pisk. Dritanit iu desh të mësonte gjermanishten për tetë muaj. Spanjishten kishte vite që e fliste, kurse, pas disa zhvillime të mëvonshme, do të detyrohej të mësonte frëngjisht. Kulla e Babelit, po pengohej sërish të ngrihej. Djali po rritej, por meksikania nuk ishte dakort për të nisur një fëmijë tjetër. Nëse në Botën e Tretë, vdisnin akoma fëmijë nga uria, në vendet e zhvilluara, sundonte planifikimi familjar. Ko botë, nuk mund të mbante njerëz pafund, njerëzimi duhet të jetonte në paqe me mjedisin. Dritani nisi të lexonte Spinozën, kurse SH.B.A.-të dhe Rusia, ranë dakort për çarmatimin.

Besimi në Amerikë, ishte në tranzicion. Hebrejtë, ata që krijuan Dhjatën e Vjetër dhe që inspiruan të gjitha besimet judaiste që dominojnë sot botën, po përgatisnin terrenin për një besim të ri. Perandori e re, besim i ri. Kjo gjë kërkonte kohë që të ngjizej, por Dritanit kjo gjë i interesonte pak ose aspak. Atë dhe të shoqen, i shqetësonte konflikti i njeriut me mjedisin. Sa herë ngjante ndonjë katastrofë ekologjike, ata të dy gjenin sërish punë, po kur gjërat harroheshin, ktheheshin sërish vështirësitë për ta. Shpesh, arrinin të

merrnin edhe projekte që flisin për mbrojtjen e qenëve, të arushës së bardhë, fokës me mustaqe apo balenës nordike. Ndërsa luftonin me... dhe për njerëzimin, filluan të duan kafshët. Në fshatin e tij të lindjes, dikush mburrej me arritjet e Dritanit, një tjetër e kundërshtonte apo mendonte se duhej të merrej me politikë, por shumica tallej me projektet e tij.

Ishin në Itali, kur shpërtheu pandemia. Djali ishte me studime në Londër. Fillimisht, menduan se do të kishin kohë për të shijuar mrekullitë që të ofronte gadishulli i Apenineve, por shumë shpejt, iu desh të mbylleshin në karantinë. Në fillim u infektua teksania, pastaj edhe Dritani. Ditën e dhjetë, shoqja e tij vdiq. U varros në Shën Pjetër, nën vështrimin e përhumur të të shoqit, një frati françeskan dhe dy varrmihësve. Dritanit iu kujtuan fretërit françeskan të shekullit të njëzet, shpirti, mendja dhe djersa e tyre u derdh pa kursim për Shqipërinë; kurse Shqipëria totalitare, nën sundimin e injorancës arriviste, ua ktheu më të fuqishme urrejtjen dhe persekutimin. Vdekjet shtoheshin me progresion gjeometrik, kurse ai mundohej të qetësonte të birin, që i qante në telefon nga Londra. Nuk e humbi për asnjë çast besimin, ndoshta ishte edhe çështje trashëgimie. Ndihej si një Zot i atyre gjallesave në trupin e tij dhe gjëja që donte më tepër ato ditë, ishte mundësia që të vendoste një urë komunikimi me ta. Kur numri i të vdekurve nisi të binte, Dritani dha një intervistë te RAI, ku foli për nevojën e një kontrate të re, mes njeriut e mjedisit.

E keqja nuk ka kaluar akoma, por një sprovë e tillë, nuk është as e para as e fundit për njerëzimin. As më e vështira, as më e tmerrshme. Njerëzimi, ka dalë gjithnjë fitimtar, por tanimë, ka ardhur koha për të ndërtuar një strategji të qartë. Njerzit duhet ta shohin në sy të vërtetën e të luftojnë për të. E keqja është aq e vogël sa nuk ua merr mendja, po është aq mirë e organizuar, saqë duket kaq e frikshme. Ka ardhur koha që e mira të organizohet. Duhet të gjejmë paqen me mjedisin. Duhet të gjejmë dashurinë për njeri-tjetrin. Duhet ta adhurojmë Zotin-Natyrë... Dritani ishte plot me ide të reja për projekte, andaj, mezi priste që të kalonte edhe kjo e keqe. Kur u njoftua fitorja mbi virusin, ai kishte fituar një projekt dhe ishte njohur me një bionde simpatike nga mesdheu verilindor.

